



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

K.DH.SH.II.nr.97/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhomat e Shkalles se Dytë, me gjyqtarin Krenar Berisha, në çështjen përmbartimore të kreditorit Teuta Cos Shpk, me seli ne Prizren rr. “Ferizaji” nr.37, me pronare H.J., te cilën sipas autorizimit e përfaqëson avokat A.A. nga Prizreni, ndaj debitorit Swiss Bau Shpk, me adresë ne lagjen “Arbana” ne Prizren, te cilën sipas autorizimit e përfaqëson avokat V.O. nga Prizreni, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorit te ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prizren - Departamenti i Përgjithshëm, PPP.nr.155/2021 i datës 23.12.2021, me datë 26.01.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

APROVOHET e themeltë ankesa e debitorit Swiss Bau Shpk, me adresë ne lagjen “Arbana” ne Prizren, ANULOHET aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prizren-Departamenti i Përgjithshëm, PPP.nr.155/2021 i datës 23.12.2021 dhe Lënda i kthehet Gjykatës Komerciale –Dhoma e Shkallës së Parë, në rishqyrtim dhe rivendosje.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prizren - Departamenti i Përgjithshëm, me aktvendimin e atakuar PPP.nr.155/2021, të datës 23.12.2021, e ka Refuzuar ne tërësi si të pabazuar prapësimin e debitorit Sëiss Bau Shpk, me adresë ne lagjen “Arbana” ne Prizren, i ushtruar kundër urdhrin për përmbartim P.nr.834/21 të datës 26.05.2021, i lëshuar nga Përmbartuesi Privat Enis Hoxha ne Prizren, duke e lënë ne fuqi urdhrin përmbartimor, ndërsa ka vendos qe pala e cila e humb procesin gjyqësor-përmbartimor do ti bartë te gjitha shpenzimet e përmbartimit.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor, ka ushtruar ankesë debitori përmes përfaqësuesve të autorizuar, si dhe ka bërë plotësim ankese, për shkak të shkeljeve esenciale te dispozitave te procedurës përmbartimore, vërtetimit te gabuar dhe jo te plotë te gjendjes faktike dhe zbatimit te gabuar te se drejtës faktike, me propozim që Gjykata e shkalles se dytë, ta aprovoj si të bazuar ankesën e debitorit, aktvendimin e ankimuar ta prish ashtu qe lënda të kthehet ne shkallë te parë në rivendosje ose aktvendimi i ankimuar te ndryshohet, prapësimi i debitorit te aprovohet dhe të lihet jashtë fuqie urdhri përmbartimor i përmbartuesit privat.

Në përgjigjen në ankesë i autorizuari i kreditorit e kundërshton në tërësi ankesën e debitorit duke i propozuar gjykatës që ankesën e debitorit ta refuzoj si të pabazuar dhe aktvendimin e gjykatës së shkallës së parë ta vërtetoj.

Dhoma e Shkallës së Dytë, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar, pretendimet ankimore, përgjigjes në ankesë. në kuptim të nenit 3, paragrafi 2, të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbartimore si dhe në kuptim të nenit 194 dhe 208 të LPK-së, gjeti se:

-Ankesa e debitorit është e bazuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori Teuta Cos Shpk, me seli ne Prizren rr. "Ferizaj" nr.37, me pronare H.J., me datën 25.05.2021, ka paraqitur propozim për përmbartim ndaj debitorit Swiss Bau Shpk, me adresë ne lagjen "Arbana" ne Prizren, në bazë të dokumentit të besueshëm-Faturës me nr.9 e datës 17.05.2021.

Përmbartuesi Privat Enis Hoxha nga Prizreni, sipas propozimit te kreditorit, me urdhrin përmbartimor P.nr.834/2021 dt.26.05.2021, ka lejuar përmbartimin, me të cilën detyrohet debitori qe në emër të borxhit, kreditorit t'ia paguajë shumën prej 423,930.09 euro, me kamatë ligjore prej 8% vjetore duke filluar nga dita e paraqitjes se propozimit për përmbartim.

Kundër urdhrin përmbartimor debitori ka ushtruar prapësim me datën 31.05.2021, duke kundërshtuar ne tërësi propozimin për përmbartim dhe urdhrin për përmbartim, sepse dokumenti ne bazë te cilit është bërë propozimi për përmbartim është dokument fiktiv dhe joligjor, i panënshkruar dhe pa vulosur nga debitori ashtu qe si i tillë nuk ka tipare te përmbartueshmërisë. Se fatura nr.9 dt.17.05.2021 është e pambështetur ne një punë juridike, se fatura është fiktive është edhe një përgjigje e datës 17.05.2021 si dhe dokument kartela e partnerit e cila është e nënshkruar vetëm nga debitori, me konstatim te detyrimit vetëm nga pala kreditore, propozon qe gjykata ne rast te shqyrtimit te prapësimit te caktoj seancë gjyqësore për te shpjeguar te gjitha pretendimet e palës debitore dhe pastaj te vendos si ne propozim te këtij prapësimi, ashtu qe ta aprovoj si te bazuar këtë prapësim, urdhri përmbartimor te mbetet jashtë fuqie dhe propozimi i kreditorit te refuzohet si i pabazuar dhe joligjor.

Përgjigje ne prapësimin e debitorit ka paraqitur kreditori me datën 02.06.2021, me arsyetimin se pretendimi i debitorit se fatura nuk është e përshtatshme për përmbartim dhe se e njëjta nuk është e nënshkruar dhe e vulosur dhe se detyrimi nga kjo fature është jo ekzistues dhe joligjor bie ne kundërshtim pasi debitori e ka pranuar faturën nr.9, e cila konsiderohet dokument i besueshëm dhe se detyrimi i saj rrjedh nga situacioni nr. 26/SB-2021 përmes se cilës janë kryer punimet ne objektin banesor 2B+P+VII Ortakoll, , debitori ne kundërshtimin e tij nuk ka ofruar asnjë provë bindëse dhe se kundërshtimi i tij ka për qëllim shmangien nga përmbushja e obligimit, andaj propozon qe gjykata ta refuzoj prapësimin e debitorit dhe urdhrin përmbartimor ta lë ne fuqi.

Gjykata Themelore në Prizren, pas vlerësimit të prapësimit dhe përgjigjes në prapësim, ka nxjerrë aktvendimin PPP.nr.155/2021 dt.23.12.2021, me të cilin e ka Refuzuar ne tërësi si të pabazuar prapësimin e debitorit, duke vendosur decidivisht si në dispozitiv të aktvendimit të atakuar. Në arsyetim të aktvendimit të atakuar ka arsyetuar se ne rastin konkret dokumenti përmbartimor është fatura përkatëse ne te cilën janë treguar debitori, kreditori, objekti, shuma e detyrimit te kërkuar ne te holla, dhe koha e përmbushjes se detyrimit. Sipas shkresave ne lëndë shihet se kreditori i përmbartimit faturën ne fjalë te cilën e ka propozuar ia ka dorëzuar përmes dorëzimit postar ne adresën e vet debitorit te cilin dorëzim e njej gjykata si te rregullt dhe atë duke u bazuar ne nenin 103 par.1 te LPK. Arsyeton se detyrimi i debitorit rrjedh nga

një raport kontraktual i nënshtruar mes palëve ndërgjyqjese që ky detyrim rrjedh nga neni 28 par.3 i Kontratës mbi Ndërtimin nr.LRP.782/2019 dt.28.02.2019 andaj debitori ka qene ne dijeni për detyrimin tij dhe atë sipas situatës nr.26/SB-2021 dt.17.05.2021. Vlerëson se pala debitore nuk ia ka bashkangjitur asnjë provë të vetme prapësimi ashtu që nuk plotësohen arsyet ligjore nga neni 71 te LPP, andaj edhe vendosi si ne propozim te këtij aktvendimi.

Gjykata Komerciale -Dhoma e shkallës së Dytë, qëndrimin dhe përfundimin juridik të gjykatës së shkallës së parë nuk mund ta përkrah si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsye se aktvendimi i atakuar është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika (n) e LPK-së, në vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike nga neni 183 të LPK-së, si dhe me shkelje të nenit 29 paragrafi 1 pika 1.3 të LPP-së.

Në këtë kontekst, kjo gjykatë vlerëson, se gjykata e shkallës së parë nuk ka analizuar saktë gjendjen faktike përkitazi çështjes kryesore se fatura përbarimore nr.9 e datës 17.05.2021 bashkangjitur propozimit për përbarim të kreditorit, a i përmbush te gjitha kushtet për te qenë dokument i besueshëm ashtu siç kërkohet me dispozitat ligjore nga neni 29 te LPP. Nga shkresat e lëndës shihet qartë se fatura nr.9 e dt.17.05.2021, në bazë të cilës është lejuar përbarimi është e pa nënshkruar dhe e pavulosur nga ana e debitorit, pra nuk përmban elementet që kërkohen me nenin 29 par.3 te LPP i cili thotë se: *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përbarim po që se ne të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, shumat dhe koha e përmbushjes se detyrimit monetar, po ashtu edhe Udhëzimi Administrativ Nr. 15 /2010 PËR ZBATIMIN E LIGJIT NR. 03/L-222 MBI ADMINISTRATËN TATIMORE DHE PROCEDURAT, neni 20 par.1 nenpar.1.17, parasheh që “Në minimum, një faturë duhet të jetë e nënshkruar nga shitësi, nëse klienti apo blerësi është dispozicion për të nënshkruar, ai person duhet po ashtu të nënshkruajë faturën tatimore”*,

Bazuar në kushtet e përcaktuara me këto dispozita ligjore, fatura nuk mund të ketë fuqinë e dokumentit të besueshëm nëse mungon ndonjë nga kriteret që e bën atë të përshtatshme për përbarim. Fakti se debitori nuk e ka pranuar faturën me nënshkrimin e tij, nuk i jep faturës fuqinë e dokumentit të besueshëm dhe i njëjti nuk mund të jetë i përshtatshëm për përbarim dhe se fakti se njëra palë i ka dërguar faturën përmes dërgesës postare tek pala tjetër nuk nënkupton dërgim të rregullt, përderisa debitori nuk ka pasur njohuri për përmbajtjen e dërgesës, ashtu që fatura të ketë fuqinë e dokumentit të besueshëm do të duhej që e njëjta të jetë e pranuar në mënyrë të rregullt nga debitori. Në të kundërtën vetëm dërgimi i tillë postar pa u specifikuar se çka përmban ai dërgim si ne rastin konkret është devijim i kushteve ligjore dhe pranueshmërisë së detyrimit që përmban fatura.

Dhoma e shkallës së dytë vlerëson se nuk gjen zbatim neni 103 paragrafi 1 i LPK-së, sikurse ka vepruar gjykata e shkallës së parë, e cila dorëzimin postar, e njeh si të rregullt duke konsideruar se debitori përmes dorëzimit postar nga kreditori ka pranuar faturën përbarimore nr.9 datës 17.05.2021.

Andaj me qëllim të vlerësimit dhe verifikimit te faturës si dhe analizimit te pretendimeve te palëve ne procedurë, kjo gjykatë vlerëson se gjykata e shkallës së parë duhet ta këtë parasysh nenin 73 paragrafi 1 të LPP-së, i cili thotë, se: *“Gjykata mund të vendosë lidhur me prapësimin jashtë seancës gjyqësore. Përjashtimisht Gjykata mund të caktojë seancë publike nëse vlerëson*

se kjo është e domosdoshme për të kuptuar plotësisht validitetin e prapësimit. Gjykata do të njoftojë të gjitha palët për dëgjimin publik. Nëse Gjykata vendos të mbajë seancë dëgjimore publike, seanca dëgjimore do të mbahet brenda pesë (5) ditëve, kur kërkohet që përgjigjet ndaj prapësimit të pranohet nga gjykata”, arsye këto nga te cilat rezulton se aktvendimi i ankimuar duhet të anulohet dhe çështja të kthehet në procedim të serishëm në gjykatën e shkallës së parë.

Në ri procedurë, Dhoma e shkallës së parë duhet të ketë parasysh të gjeturat e Dhomës së shkallës së dytë, të vlerëson në mënyrë të drejtë dokumentin e besueshëm, dhe faktin vendimtar mënyrën e pranimin të faturës përmbarimore nga debitori, sipas nevojës dhe rrethanave të caktoj seancë dëgjimore në kuptim të dispozitave të lartcekura, e më pastaj varësisht nga të gjeturat edhe të vendos konform dispozitave ligjore duke marrë aktvendim të drejtë dhe të ligjshëm.

Nga sa u tha me lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi në kuptim të nenit 77 dhe 17 të LPP-së, lidhur me nenin 208 dhe 209, pika d), të LPK-së.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhoma e Shkallës së Dytë

K.DH.SH.II nr.97/23 me datë 26.01.2024

**Gjyqtari,
Krenar Berisha**